

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatori ekonomik “Shansi Invest” sh.p.k, NIPT J61924002T, me adresë:
Rruga Reshit Çollaku, Pallati 4, Shkalla 8, Apartamenti 7, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur mbi kufirin e larte monetar, mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: NR.REF- 74437-07-06-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “FV impianti i ri 0.4kV i nevojave vetjake të përgjithshme të centralit, me dy hyrje 3200 A dhe seksionar me automatik change over e mbrojtjes termomagnetike, daljet me kontroll manual 400A dhe 800/1000A, pajisur me mbrojtje termomagnetike”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.61, datë 10/07/2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Bashkimi i operatorëve ekonomik “ITE Group” sh.p.k NIPT K11323001H & “ITE Engineering” sh.p.k NIPT L61530001I me vlerë oferte ekonomike 39,000,000 (Tridhjetë e nëntëmilion) Lek pa TVSH;
- 2- Operatori ekonomik “HTM sh.p.k NIPTI K97006004D me vlerë oferte ekonomike 53,922,000 (Pesëdhjetë e tremilion e nëntëqind e njëzet e dymijë) Lek pa TVSH
- 3- Operatori ekonomik “Shansi Invest” sh.p.k NIPT J61924002T me vlerë oferte ekonomike 64,082,820 (Gjashtëdhjetë e katërmilion e tetëdhjetë e dymijë e tetëqind e njëzet) Lek pa TVSH
- 4- Operatori ekonomik “Albesol” sh.p.k NIPT L42307014K me vlerë oferte ekonomike 61,750,000 (Gjashtëdhjetë e njëmilion e shtatëqind e pesëdhjetë) Lek pa TVSH

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1- Bashkimi i operatorëve ekonomik “ITE Group” sh.p.k NIPT K11323001H & “ITE Engineering” sh.p.k NIPT L61530001I, pasi:

- Referuar kontratës së bashkëpunimit të datës 27.07.2023 të paraqitur nga “BOE ITE Group sh.p.k & ITE Engineering sh.p.k”, është përcaktuar dhe ndarja e pjesmarrjes në këtë bashkëpunim: -ITE Group sh.p.k 90 % e cila merr përsipër të kryej furnizimin e impiantit

0.4 KV dhe pjesët rezervë ; -ITE Engineering sh.p.k 10% merr përsipër të kryej demontimin e impiantit ekzistues.

- Bazuar në ofertën ekonomike dhe listën e çmimeve të artikujve të paraqitur nga bashkimi i operatorëve, rezulton se ITE Group sh.p.k përmbush 84.85 % të vlerës së ofertës dhe ITE Engineering sh.p.k 16.15% të vlerës së ofertës. Pra ndarja e përqindjes së ofertës ekonomike nuk është e njëjtë me ndarjen e përqindjes së deklaruar në kontratën e bashkëpunimit.
- Formulari i vetëdeklarimit të paraqitur nga ITE Group sh.p.k nuk është sipas formatit të shtojces 8 të DT mallra por sipas formatit të shtojcës 8 DT punë.
- Formulari i vetëdeklarimit të paraqitur nga ITE Engineering sh.p.k nuk është sipas formatit të shtojces 8 të DT mallra por sipas formatit të shtojcës 8 DT punë.
- BOE nuk ka paraqitur sigurim oferte.
- BOE nuk plotëson kriterin 2.3.5 pasi, çertifikata për panelet TU e paraqitur nga OE nuk është çertifikatë e lëshuar nga vetë prodhuesi apo institucion i autorizuar. Për më tepër, në çertifikatë është e përmendur që “S. Z” është i trajnuar për impiante shpërndarës civile (Switchboard), me automate modulare, që nuk kanë lidhje me “Switchgear” impiantet industriale.
- BOE nuk plotëson kriterin 2.3.9 pasi, sipas katalogut teknik të paraqitur nga OE, është ofertuar impianti shpërndarës “PrismaSet P”, ku në të dhënat e katalogut të prodhuesit Schneider është impiant shpërndarës jo industrial (Switchgear) me çelësa automate me micrologic, por është panel shpërndarje për ndërtesa civile me automate modulare.

2- Operatori ekonomik “HTM sh.p.k NIPTI K97006004D, pasi:

- Formulari i vetëdeklarimit të paraqitur nga HTM sh.p.k nuk është sipas formatit të shtojces 8 të DT mallra por sipas formatit të shtojcës 8 DT punë.
- Formulari i ofertës i paraqitur nga HTM sh.p.k nuk është sipas formatit të shtojces 1 të DT mallra por sipas formatit të shtojcës 1 DT punë.
- Shtojca 2 Lista e artikujve e paraqitur nga HTM sh.p.k nuk është sipas formatit të shtojces 2 të DT mallra por sipas formatit të shtojcës 2 DT shërbim.
- OE HTM sh.p.k nuk plotëson kriterin 2.3.10 pasi nuk ka paraqitur test raporte të impiantit shpërndarës, që të vërtetetojë që prodhuesi ka kapacitete teknike që mund të realizojë të gjitha testimet sic janë kërkuar në specifikime teknike. Dokumentet e paraqitur në sistem të pretenduara si test raporte, janë vetem katalogje të ABB për impiantin shpërndarës Neo Gear. Sa më sipër OE nuk garanton që impianti do të prodhohet dhe testohet sipas standarteve IEC dhe kërkesave në specifikimet teknike

3- Operatori ekonomik “Albesol” sh.p.k NIPT L42307014K, pasi:

- OE Albesol sh.p.k nuk plotëson kriterin 2.3.5 pasi: Çertifikatat per panelet TU e paraqitur nga OE nuk janë certifikata të lëshuara nga vetë prodhuesi apo institucion i autorizuar. Për më tepër, në certifikatë është e përmendur që “B. S” është i trajnuar për impiante shpërndarës TU Prisma P deri 630A, dhe Prisma G deri 4000A që janë impiante civile (Switchboard), me automate modulare, që janë sisteme shumë të ndryshme nga impiantet industriale (Switchgear).

Sa më sipër OE nuk ka kapacitete teknike për punime me impante TU industriale konkretisht për rryma 3200 A me çelësa automatike, me komandim nga distanca per automatikë “change-over”. Asemblimi, instalimi dhe realizimi i skemës shpërndarese në impiantet industriale me komandim nga distanca, me automatike “change-over” është punë e një niveli të lartë teknologjik dhe kërkon staf teknik të trajnuar specifikisht për tipin e impiantit që do ofertohej.

- OE Albesol sh.p.k nuk plotëson kriterin 2.3.6 pasi: Çertifikata IEC 60068 e paraqitur nga OE dëshmon se prodhuesi plotëson kërkesat e standartit për modelet Prisma G dhe Prisma P që janë panele shpërndarje me automate modulare. Modeli i impiantit shpërndarës të paraqitur nga OE nuk është në përputhje me parametrat e panelit 13LKA ne HEC Koman, ku sipas specifikimeve është impiant shpërndares industrial (Switchgear). OE duhet të vërtetojë që realizon testet ambjentale për të njëjtin tip Impianti Shpërndarës që ka ofertuar, që sipas katalogut është OKKEN.

Nuk mund të dëshmohej realizimi i testeve ambjentale të impianteve Industriale me certifikata testesh të impianteve shpërndarës që përdoren për furnizimin me energji të godinave civile.

- OE Albesol sh.p.k nuk plotëson kriterin 2.3.10 pasi: OE nuk ka paraqitur test raporte që prodhuesi realizon në lidhje me impiantin e ofruar OKKEN, në mënyrë që të vërtetohet se OE ka siguruar kapacitet teknike për të realizuar të gjitha testet sipas specifikimeve teknike për impiantet. OE ka paraqitur test raporte për tjetër tip impianti shpërndarës (Prisma G, Prisma P) që janë sisteme shpërndarëse me automate modulare për ndërtesa civile.

Me “test report” kuptohet një procedure testimi që është realizuar për impiante të ngjashme dhe tregohen testet e realizuar konkretisht, metodikat e testimit, dhe rezultatet e tyre. Në asnjë dokument të paraqitur nga OE nuk paraqiten teste konkrete, që të vërtetohen testet sipas specifikimeve teknike.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Shansi Invest” sh.p.k NIPT J61924002T, me adresë: Rruga Reshit Çollaku, Pallati 4, Shkalla 8, Apartamenti 7, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 64,082,820 (Gjashtëdhjetë e katërmilion e tetëdhjetë e dymijë e tetëqind e njëzet) Lek pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor KESH sh.a, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*): Nuk ka.

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ergys Verdho